



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2769/ 6 Prot.,

Datë 30.10.2024

V E N D I M

Nr. 1523 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2024 me

Objekt:

Mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering) për nevojat e Reparteve Ushtarake të Forcave të Armatosura, ndarë në 9 (nëntë) Lote”, me Nr. REF-12959-07-12-2024, **Loti 5** me nr REF-12969-07-12-2024, me objekt “*Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër”* me fond limit 408,646,628. Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “DION-AL” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar

Ankimues:

Operatori ekonomik “DION-AL” SHPK me Nipt K67917301H dhe *Bulevardi Gjergj Fishta , Kulla 2, kati 2, Tiranë.*

BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK”, me Nipt J76705047U dhe K88010301S, Adresa: Lagjja Vasil Shanto, Bul. Skënderbeu, godine 8 kate, kati I-rë, Z.Kadastrale 8593.Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
Adresa: Blv “Dëshmorët e Kombit” NR.3, 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, të autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraparak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues, për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.07.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me nr REF-12969-07-12-2024 me objekt “Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër” me fond limit 408,646,628. Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 17.09.2024, ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.), dhe ka kryer renditjen e rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. “DION-AL” SHPK	skualifikuar
2. BOE “NIKA ShPK & SILVER ShPK	skualifikuar

II.3. Autoriteti Kontraktor më datë 18.09.2024 ka publikuar Njoftim Anulimi të procedurës.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi ankimi elektronik me nr. A/2024/4600 si dhe nr. protokollit 2769/2024 datë 27.09.2024 i operatorit ekonomik “DION AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me nr REF-12969-07-12-2024 me objekt “Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër” me fond limit 408,646,628.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “DION-AL” SHPK nga procedura e prokurimit sipërcituar.

-Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate. Licenca e paraqitur nga OE “DION-AL” shpk LN-8823-10-2019, ka veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)” e cila nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç

gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim cateringu.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 2769/2 prot., datë 27.09.2024 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.6. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka mbërritur shkresa nr. 798/28 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me Nr.2769/3, datë 09.10.2024, me objekt: *Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK ” drejtuar KPP-së dhe OE “DION-AL” SHPK.*

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin nr. 798/26 prot., datë 04.10.2024 të KSHA-së ka vendosur mospranim të ankesës.

II.7. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4602 datë 27.09.2024 dhe me Nr. 2771/2024 Prot., date 27.09.2024 e BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me nr REF-12969-07-12-2024 me objekt “Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër” me fond limit 408,646,628.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit sipërcituar.

BOE “NIKA & SILVER”sh.p.k.

S’kualifikohet -Antari i BOE operatori ekonomik “SILVER” shpk me NUIS K88010301S nuk plotëson pikën 2.3.4, të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) mjete transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore.

Në kontratën e bashkëpunimit Nr. Repertori 4579, Nr. Koleksioni 1956 datë 19.08.2024 lidhur mes shoqërisë “S I L V E R” shpk me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U , në faqe 2 , paragrafi i fundit, 4 “Pjesëmarrja” është përcaktuar se shoqëria “SILVER” shpk do të ketë një pjesëmarrje prej 15% të sasisë totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër, dhe konkretisht shpërndarjen dhe transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit. Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga shoqëria “SILVER” shpk, rezulton se kjo shoqëri nuk disponon

një automjet frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore që ka marrë përsipër të realizojë.

-Bashkimi i përkohshëm midis dy subjekteve nuk plotëson kërkesat pikes 2 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pasi sigurimi i oferëts Garanci Bankare Nr.270 dt.23.08.2024 është paraqitur në emër të subjektit “NIKA” sh.p.k, në kundërshtim me parashikimet e VKM ku përcaktohet se “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.”

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 2771/2 prot., datë 30.09.2024 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.9. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka mbërritur shkresa nr. 798/29 prot., datë 07.10.2024, protokolluar me tonën me Nr.2771/3, datë 09.10.2024, me objekt: *Mbi shqyrtimin e ankesës e BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” drejtuar KPP-së dhe BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK.*

II.10. Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, nuk janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK”. me anë të të cilës kundërshton arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

-Bashkimi i përkohshëm midis dy subjekteve nuk plotëson kërkesat pikes 2 të Nenit 88 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 “per miratimin e rregullave te prokurimit publik” pasi sigurimi i oferëts Garanci Bankare Nr.270 dt.23.08.2024 është paraqitur në emër të subjektit “NIKA” sh.p.k, në kundërshtim me parashikimet e VKM ku përcaktohet se “Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.”

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin nr. 798/27 prot., datë 04.10.2024 të KSHA-së ka vendosur pranimin e pretendimeve të ankimuesit për arsyen e dytë të skualifikimit me argumente si vijon:

“Lidhur me pretendimet e BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” mbi kundërshtimin e Vendimit të komisionit të vlerësimit të Ofertave në lidhje me arsyen e skualifikimit Garanci Bankare Nr.270 dt.23.08.2024 është paraqitur në emër të subjektit “NIKA” sh.p.k, në kundërshtim me parashikimet e VKM, KSHA arsyeton se:

Pas verifikimeve të këtij dokumenti konstatohet se operatori ekonomik NIKA ShPK, si përfaqësues me prokurë i BOE ka paraqitur sigurimin e ofertës konform parashikimeve të pikës 2 të nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në përmbushje të plotë të kërkesës sipas germës “b”, pika 1 e kritereve të vecanta për kualifikim të DT-së se: Sigurimin e Ofertës, sipas shtojcës 5”

Sa më sipër pretendimet e operatoriti ekonomik ankimues qëndrojnë.

KSHA Vendosi

- 1. Pranimin e pjesshëm të ankesës së paraqitur nga BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK”.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik brenda ditës së nesërme të punës brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*

III.1.2. Neni 30/1 i L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. “

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 i L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : 1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III. 1.4. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK”, në lidhje me arsyen e dytë të skualifikimit të ankimuesit, në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-12969-07-12-2024 me objekt “Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër” me fond limit 408,646,628.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Komisioni do të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës .

III. 2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK”, mbi arsyen e skualifikimit:

BOE “NIKA & SILVER”sh.p.k.

S’kualifikohet -Antari i BOE operatori ekonomik “SILVER” shpk me NUIS K88010301S nuk plotëson pikën 2.3.4, të seksionit 2.3 Kapaciteti Teknik, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e 1 (një) mjete transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore.

Në kontratën e bashkëpunimit Nr. Repertori 4579, Nr. Koleksioni 1956 datë 19.08.2024 lidhur mes shoqërisë “S I L V E R” shpk me NUIS K88010301S & “NIKA” me NUIS J76705047U , në faqe 2 , paragrafi i fundit, 4 “Pjesëmarrja” është përcaktuar se shoqëria “SILVER” shpk do të ketë një pjesëmarrje prej 15% të sasisë totale Loti 2: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër, dhe konkretisht shpërndarjen dhe transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit. Referuar formularit të vetëdeklarimit të paraqitur nga shoqëria “SILVER” shpk, rezulton se kjo shoqëri nuk disponon një automjet frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.1. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3, “Parime të përgjithshme” i L. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 21, “Autoriteti ose enti kontraktor” i L.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.2. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.4. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[...]”

Neni 42, pikat 1,2,3 dhe 6, “Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote” i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

6. Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve se sa numri maksimal, autoriteti/enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen. Këto kriterë duhet të jenë në përputhje me LPP-në dhe me ato të përcaktuara në nenin 91 të këtyre rregullave.

III.2.5. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcat:

Shtojca 10, KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi :

- a. 1 (një) mjet transporti frigoriferik kur ofertojnë për 1 -3 tre lote;
- b. 2 (dy) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 4-6 lote dhe
- c. 3 (tre) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 7-9 lote.

Kto mjete shërbejnë për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 11 FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet/ Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020

“Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijsëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

-Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

-Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

-Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: _____
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

-Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.

-Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

-Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

-Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

-Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për

vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

-Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.6. Referuar dokumentacionit ngarkuar në SPE të BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” rezulton, se në përmbushje të kriterit 2.3.4 sipërpecituar, operatori ekonomik “SILVER” ShPK ka ngarkuar shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, të plotësuar dhe të vulosur në tërësi, dhe në veçanti: **Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit** është plotësuar si vijon: **A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”**

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e shërbimeve dhe grafikun ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [X] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 3
	<u>Profili i punonjësve</u> 1. M. M. - Sanitare 2. I. K. - Shpërndarës ushqimi. 3. J.S. - Shofer.
	<u>Makineri e mjete</u> Po [X] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete: 1- Pajisje kuzhine per gatim 2- Frigorifere 3- Pajisje per servirje ushqimi, etj.
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Si edhe dokumenti: **Deklaratë Transporti** e OE “SILVER” ShPK, ku deklaron...

“Marrim pësipër të kryejmë shërbimin e transportit të produkteve ushqimore me mjetet tona, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor.

III.2.7. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se AK me kriterin 2.3.4 ka kërkuar:

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi :

1 (një) mjet transporti frigoriferik kur ofertojnë për 1 -3 tre lote;

2 (dy) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 4-6 lote dhe

3 (tre) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 7-9 lote.

Këto mjete shërbejnë për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari,

përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Në përmbushjen e kriterit mbi disponimin e makinerive dhe mjeteve, BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” ankimues ka dorëzuar shtojcën 11 të plotësuar, emërtuar FORMULARI_VETDEKLARIMIT_SILVER

Referuar dokumentit Komisioni vërehet se ankimuesi ka plotësuar shtojcën si vijon::

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” Makineri e mjete Po [X] Jo []

Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

- 1- Pajisje kuzhine per gatim
- 2- Frigorifere
- 3- Pajisje per servirje ushqimi, etj.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Ligji për Prokurimin Publik i ndryshuar në nenin 14, pika 2 e tij ka parashikuar edhe mënyrën e paraqitjes së ofertës nga grupe operatorësh ekonomikë si një kandidat i vetëm. Nga LPP është bërë rregullimi me akt nënligjor i paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh ekonomikë dhe është pikërisht nëneni 83, i VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili i jep mundësinë operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ofertës si një bashkim operatorësh ekonomikë, duke përcaktuar pjesën e punës, shërbimit ose mallit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në pikën 3, të po këtij neni, përcaktohet edhe mënyra e përmbushjes së kriterëve nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret bashkimi i operatorëve ekonomikë “Nika” SHPK & “Silver” SHPK”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: Kontratë Bashkëpunimi Nr.rep. 4579 dhe Nr. Kol. 1956, datë 19.08.2024, me palë Shoqëria NIKA SHPK dhe shoqëria SILVER SHPK e noterizuar, sipas të cilës përqindja e pjesmarrjes në këtë bashkim do të jetë si më poshtë:

Shoqëria “NIKA” Shpk 85%. (kryesuese e BOE-se) dhe Shoqëria “SILVER” Shpk 15%

Realizimi i shërbimeve do të jetë:

Shoqëria “NIKA” Shpk do të kryejë këto shërbime: shërbim gatimi dhe shpërndarjen e transportit të ushqimit për në ambientet e AK-së si dhe mirëmbajtjen e ambienteve të gatimit, nëpërmjet personelit në dispozicion: Drejtues teknik, kryeguzhinier, ndihmëskuzhinier, shpërndarës të ushqimit, sanitar edhe shofer.

Shoqëria “SILVER” Shpk do të kryejë shërbimin e shpërndarjes dhe transportit të ushqimit për në ambientet e Autoritetit Kontraktor si dhe mirëmbajtjes së ambientit të gatimit , nëpërmjet personelit në dispozicion: një shpërndarës të ushqimit, 1 sanitar dhe 1 shofer.

Referuar sa më sipër vërehet se sipas ndarjes së shërbimeve që do të realizohen nga operatorët pjesmarrës në këtë BOE, rezulton se transporti i ushqimeve drejt AK-së do të kryhet nga të dy OE, që në referim të Nenit 88, pika 3 e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin

76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Në rastin konkret, Komisioni konstaton se, referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punëve dhe shërbimeve në ofertën e paraqitur, ku janë përcaktuar shërbimet, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “NIKA” SHPK dhe “SILVER” Shpk, kanë marrë përsipër të kryejnë furnizimin me produkte ushqimore, transportin e ushqimit të gatuar dhe shpërndarjen e ushqimit, për të cilat është i nevojshëm mjete frigoriferik, **sipas kriterit kualifikues: 2.3.4** ka kërkuar:

[...]Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi :

1 (një) mjet transporti frigoriferik kur ofertojnë për 1 -3 tre lote;

2 (dy) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 4-6 lote dhe

3 (tre) mjete transporti frigoriferike nëse ofertojnë për 7-9 lote.....

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 11 të DT [...]

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi në SPE, konkretisht, dokumentit 2_FORMULARI_VETEDEKLARIMIT_SILVER, Komisioni kreu verifikimet mbi përputhshmërinë e kriterit kualifikues të vendosur nga autoriteti kontraktor me dokumentet e ofertës së paraqitur në SPE nga BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” dhe konstatoi se operatori ekonomik “SILVER ShPK” ka paraqitur dokumentin Formular Përmbledhës I Vetedeklarimit, cituar mësipër, nga ku konstatohet se ky operator nuk ka arritur të përmbushë kriterin e kualifikimit mbi disponimin e mjeteve të transportit **1 (një) mjet transporti frigoriferik** , për këtë procedurë prokurimi.

Komisioni thekson se në një procedurë prokurimi, operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se ankimuesi nuk ka mundur të vërtetojë përmbushjen e kriterit kualifikues 2.3.4. të DST-së. ku edhe me paraqitjen e Kontratës së Bashkëpunimi Nr.rep. 4579 dhe Nr. Kol. 1956, datë 19.08.2024, me palë Shoqëria NIKA SHPK dhe shoqëria SILVER SHPK, ku Shoqëria “NIKA” Shpk 85%. (kryesuese e BOE-se) Dhe Shoqëria “SILVER” Shpk 15%, **referuar Realizimit të shërbimeve do të jetë:**

Shoqëria “NIKA” Shpk do të kryejë këto shërbime: shërbim gatimi dhe shpërndarjen e transportit të ushqimit për në ambientet e AK-së si dhe mirëmbajtjen e ambienteve të gatimit, nëpërmjet personelit në dispozicion: Drejtues teknik, kryeguzhinier, ndihmëskuzhinier, shpërndarës të ushqimit, sanitar edhe shofer.

Shoqëria “SILVER” Shpk do të kryejë shërbimin e shpërndarjes dhe transportit të ushqimit për në ambientet e Autoritetit Kontraktor si dhe mirëmbajtjes së ambientit të gatimit , nëpërmjet personelit në dispozicion: një shpërndarës të ushqimit, 1 sanitare dhe 1 shofer., cka do të thotë që të dy OE si pjesë e BOE-së duhet të paraqitin dokumentin Formulari Përmbledhës i Vetedeklarimit, mbi përmbushjen e kriterit kualifikues 2.3.4, për mjetin e transportit 1 (një) mjet transporti frigoriferik, përse kohë kanë marrë përsipër që të dy operatorët të shpërndarjnë ushqimin.

Gjithashtu referuar ankesës me nr, 2771/2024 ndër të tjera ankimuesi pranon se:[...] *Ne DST eshte kerkuar qe ne lidhje me kete tender te paraqitet 1 (një) mjet transporti frigoriferik (ATV) dhe 1 (nje) shofer dhe kete kriter e ka plotesuar e vetme shoqeria Nika shpk. Pra, pavaresisht faktit se shoqeria Silver shpk ka marre persiper edhe pjese te transportit te ushqimit, por pa paraqitur mjet per transportin e tij, kjo nuk e ben oferten e pavlefshme, pasi kete kriter te DST e ploteson shoqeria Nika shpk [...].*

Akoma më tej , referuar dokumentit: **Deklaratë Transporti** e OE SILVER ShPK, ku deklarohet... **“Marrim pësipër të kryejmë shërbimin e transportit të produkteve ushqimore me mjetet tona, deri në ambientet e Autoritetit Kontraktor,** Komisioni gjykon se është në përgjegjësinë e tij të kryejë shërbimin e transportit të ushqimeve me **mjet transporti frigoriferik,** për specifikën e veçantë të mallrave (ushqime të gatuar)

Përsa referuar më sipër Komisioni gjykon se ankimuesi BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” nuk ka përmbushur kriterin kualifikues 2.3.4 të DST, pasi në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nga ana e operatorit SILVER ShPK nuk është deklaruar disponimi i mjetit të transportit frigoriferik.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesi nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik **“DION-AL”** ShPK i cili kundërshton vendimin e KVO-së për arsyen e skualifikimit
-Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.1.1, të seksionit 2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë, të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit të përcaktuara në DT, lidhur me disponimin e Licencës të kategorisë II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, e cila duhet të lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

Licenca e paraqitur nga OE “DION-AL” shpk LN-8823-10-2019, ka veprimtari specifike “Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz (Restorant)” e cila nuk është në përputhje me fushën specifike të veprimtarisë objekt prokurimi e cila është “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër”. Licenca e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor duhet të përfshijë si veprimtari specifike shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e tij, pra si veprimtari specifike e licencës II.1.A.1 duhet përveç gatimit edhe shpërndarja, pra shoqëritë pjesëmarrëse duhet të kenë si veprimtari specifike shërbim cateringu.

III.3.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST Shtojca 10, FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT, 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 *Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).*

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” L. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3, “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.3. Neni 40, pika 5 i VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.3.4. Në nenin 5 të ligjit nr. 10081/2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj”

Gjithashtu, në Aneksin 3 “Përmbajtja orientuese e titullit të licencës dhe kërkesës” në pikën 8 Emertimi i veprimtarisë(ve) specifike të licencuara sqarohet se: a) Ketu vendoset emertimi i veprimtarisë specifike kur kjo është e kodifikuar. b) Kur subjekti ka kërkuar të ushtroje me shume se një veprimtari specifike, ketu vendoset emertimet e të gjitha atyre veprimtarive specifike që ka kërkuar të licencohen. c) Nëse keto shenime kërkojnë me shume se 250 karaktere atehere vihet shenimi: Per llojet e specifikimeve shih dokumentin bashkëlidhur Nr.....”

III.3.5. Në nenin 19, pika 1, të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, parashikohet shprehimisht se: *“Veprimtaritë e prodhimit primar, të përpunimit, magazinimit, ruajtjes, transportit, tregimit me shumicë apo pakicë, përfshirë edhe në hapësira të lëvizshme dhe/ose të përkohshme, të përcaktuara në këtë ligj, përfshihen në kategorinë II.1 të shtojcës së ligjit për licencat.*

Licencimi i këtyre veprimtarive, për çdo operator e për çdo stabiliment, bëhet sipas ligjit për licencat.

III.3.6. Në shtojcën e ligjit Nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht:

Fusha II. Ushqimi dhe Shëndeti

4.1. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve

5 2. Licence Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare

6 3 Licence Rritja ose tregtimi i kafshëve

7 4. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose fidanëve

8 5. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve.

9 6. Licence Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë.

10 7. Licence Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë.

11 8. Licence Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare.

III.3.7. Në aneksin 1 të VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të Përbashkëta”,

Fusha II “Ushqimi dhe Shëndeti”, Kategoria II.1 “Prodhim dhe/ose Tregtim i Ushqimeve”, parashikohet shprehimisht:

1. Veprimtaria e “prodhimit dhe/ose tregimit të ushqimeve” është kategoria II.1 e Shtojcës së Ligjit nr. 10.081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kjo licencë ndahet në këto nënkategori:

a) “Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve”, me kodin II.1.A;

b) “Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore (për njerëz)”, me kodin II.1.B;

c) “Prodhimi primar me shumicë”, me kodin II.1.C.

3. Veprimtaritë e nënkategorisë me kodin II.1.A dhe II.1.C, nuk përfshijnë veprimtaritë për të cilat parashikohet licencimi i posaçëm sipas kategorisë II.3 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

4. Licencat për nënkategoritë II.1.A, II.1.B dhe II.1.C janë pa afat.

III.3.8. Në nenin 17, “Rregulla të përbashkëta për kërkesën për licencë/autorizim/leje për të gjitha grupet” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Kërkesa për licencë/autorizim/leje apo nënkategori të tyre paraqitet në QKL, sipas procedurave të nenit 34 të këtij ligji.

2. Kërkesa përbëhet nga formulari tip i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese përkatëse.

3. Formulari tip përmban, të paktën, këto të dhëna: a) emërtimin e kategorisë /nënkategorisë; b) llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike e të përdorimit të saj; c) të dhënat për identifikimin e kërkuarit dhe të personit që paraqet kërkesën; ç) vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë, të kryerjes së veprimi apo përdorimit të së mirës; d) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë /nënkategorisë; dh) deklaratën e kërkuarit, që vërteton se i njeh kriteret e licencimit/autorizimit/lejimit dhe i përmbush ato (për kriteret, përmbushja e të cilave vetëdeklarohet);

e) deklaratën për vërtetësinë e dokumenteve shoqëruese dhe/ose që i njeh dhe/ose i pranon detyrimet e licencimit/autorizimit/lejimit dhe do t'i përmbushë ato;

ë) adresën për komunikim; f) listën e dokumenteve shoqëruese që duhet paraqitur.

4. QKL-ja nuk mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në formular.

5. Formulari i plotësuar dhe dokumentet shoqëruese, për çdo kërkesë të paraqitur, publikohen nga QKL-ja në regjistër, brenda ditës së nesërme të punës nga data e paraqitjes së kërkesës.

III.3.9. Në nenin 23, “Përmbajtja e titullit të licencës/autorizimit/lejes” të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se:

1. Licenca/autorizimit/leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj.

2. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna: a) emrin dhe stemën e QKL-së; b) serinë, numrin dhe datën e miratimit dhe të hyrjes në fuqi; c) të dhënat për identifikimin e titullarit; ç) llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj; d) vendin ku ushtrohet veprimtaria, kryhet veprimi apo përdoret e mira (nëse është përcaktuar si e dhënë e nevojshme për kategorinë/nënkategorinë); dh) kufizimet në ushtrimin e veprimtarisë, në kryerjen e veprimi apo në përdorimin e së mirës publike (nëse ka); e) afatin e vlefshmërisë; ë) nënshkrimin e përfaqësuesit të autorizuar të QKL-së dhe vulën përkatëse të institucionit; f) të dhëna të tjera specifike, sipas kategorisë/nënkategorisë; g) aneksin.

3. *Aneksi përmban të gjitha detyrimet specifike apo të përgjithshme, sipas legjislacionit në fuqi, që duhet të respektojë titullari gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së saj.*

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

KPP gjykon, se në një procedurë prokurimi operatori ekonomik ofertues është subjekti i interesuar të parqiti ofertën e tij në përputhje me dokumentet e procedurës së prokurimit në përmbushje të të gjitha kriterëve kualifikues. Mosplotësimi qoftë edhe një kriteri të vetëm përbën shkak skualifikimi.

Referuar sa më lart, vërehet, se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës së operatorit ekonomik “DION-AL” ShPK vërehet se ka ngarkuar në SPE dokumentin emërtuar,

2.1.1_Licencat _II.1_A.1_DION-AL_SHPK.pdf , - përmban disa Licenca ndër vite:

1.LICENCË -LN-3351-06-2017 NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-06-02

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë -- Qarku: Berat Rrethi: BERAT Berat B/K: Q/F: Adresa: Poshnje, Kati i Parë, Reparti Ushtarak Nr.1030, Poshnje.

2.LICENCË -LN-3344-06-2017 NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-06-06

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Durrës Rrethi: DURRES Durrës B/K: Q/F: Adresa: Lagjja nr.18, Rruga Aleksandër Goga, kati I, Spitali Rajonal Durrës.

3.LICENCË -LN-3332-06-2017 NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-06-02

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Vlorë Rrethi: VLORE Vlore B/K: Q/F: Adresa: Rruga Dytësore Bestrovë, Godina Nr.16, Ish Reparti Ushtarak (5001)

4. LICENCË -LN-2862-03-2017 NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-03-13

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Lezhë Rrethi: LEZHE Lezhë B/K: Q/F: Adresa: Rruga Luigj Gurakuqi, Materniteti Lezhë, kati i I (parë).

5. LICENCË -LN-3356-06-2017, NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-06-07

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Tiranë Rrethi: TIRANE Tirane B/K: Q/F: Adresa: Tiranë, Reparti i Ndërhryjes së Shpejtë.

6.LICENCË -LN-3531-07-2017, NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kodi II.1.A, data e lëshimit 2017-07-11

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Tirane Rrethi: TIRANE B/K: Zall Herr Q/F: Adresa: Rruga Zall Herr, Reparti 1050.

7.LICENCË -LN-8823-10-2019, NUIS/NIPT: K67917301H - DION-AL . Lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Kodi II.1.A.1 data e lëshimit 2019-10-01

Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Vendi i kryerjes së veprimtarisë - Qarku: Shkodër Rrethi: SHKODER B/K: Bushat Q/F: Adresa: Barbullush, Objekt, Kati I, Zona Kadastrale 1100, Pasuria Nr. 363/10/ND;

III.3.11 Komisioni i Prokurimit Publik në vendimmarrjen te tij i referohet fakteve të dosjes administrative, e konkretisht dokumenteve të procedurë së prokurimit dhe dokumenteve të ofertës së ankimuesit ngrkuar në SPE. Referuar dokumenteve të ofertës , ankimuesi “DION-AL” SHPK ka paraqitur një sërë licencash, cituar mësipër, ku konstatohet se Kodi i tyre është II.1.A, Kategoria - Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve. Nënkatëgoria - Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve. Veprimtari specifike - Prodhim, përpunim e shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz., Kod i cili nuk është në përputhje me /kodin e kërkuar në kriterin 2.1.1. *Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë*

“II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”. Kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Komisioni gjykon se në një procedurë prokurimi subjekti i interesuar të fitojë kontratën me autoritetin kontraktor është operatori ekonomik i cili me oferën e tij duhet të përmbushë të gjitha kriterit dhe specifikimet teknike të Tenderit për sa kohë i ka pranuar ato që me shpalljen e procedurë së prokurimit në SPE.

Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të provojë me dokumentacionin e ofertës së tij se plotëson kriterin kualifikues 2.1.1. Mbi disponimin e Licencës së kërkuar për realizimin e objektit të prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se në rast se ankimuesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, parashikuar nga neni 110, pika 1 e LPP. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, , i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Akoma më tej nga verifikimet të dokumenteve në SPE rezulton se Akti i Miratimit të kërkesës për LICENCËN LN-8823-10-2019, si Licenca e fundit e OE në SPE, me Kodin II.1.A (1), **me këto kufizime specifike "1. Restorant."**, nuk përputhet me objektin e prokurimit “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (**katering**) për nevojat e reparteve ushtarake të forcave të armatosura ndare në 9 nënte lote”.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës, për sa kohë janë pranuar prej tyre, në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit

Komisioni i Prokurimit Publik, referuar Vendimit të KSHA-së, gjykon se vendimi është i argumentuar drejtë dhe duhet të qëndrojë në fuqi.

Për sa referuar pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çeshtjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” për procedurën “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*” Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering) për nevojat e Reparteve Ushtarake të Forcave të Armatosura, ndarë në 9 (nëntë) Lot-e, REF-12959-07-12-2024, **Loti 5** me nr REF-12969-07-12-2024 me objekt “*Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër”* me fond limit 408,646,628. Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
 2. Të mos pranojë ankesën e BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK” për procedurën e prokurimit sipërcituar.
 3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “DION-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “*E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*” Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Katering) për nevojat e Reparteve Ushtarake të Forcave të Armatosura, ndarë në 9 (nëntë) Lot-e, REF-12959-07-12-2024, **Loti 5** me nr REF-12969-07-12-2024 me objekt “*Loti 5 - “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin Ushtarak nr.1010, Vau-Dejës, Shkodër”* me fond limit 408,646,628. Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 26-08-2024 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara
 4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e “BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK mbi arsyen e dytë të skualifikimit sipas vendimit të KSHA-së.
 5. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi zbatimin e vendimit të KSHA-së.
 6. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “BOE “NIKA ShPK dhe SILVER ShPK dhe operatori ekonomik “DION-AL” SHPK
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj	Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri